




Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo



PLANI VJETOR I TRAJTIMIT TË RREZIQEVE PËR VITIN 2018

Plani i vjetor i trajtimit të Rreziqeve për vitin 2018

Janar 2018, Prishtinë

Plani i vjetor i trajtimit të rreziqeve për vitin 2018, përshkruan veprimet e kundërpërgjigjes, të cilat do të sjellin produkte, të cilat priten të kenë ndikim te sjellja e tatimpaguesve lidhur me përmbushjen e detyrimeve tatimore.

Ky plan përshkruan se si mund të bëhet kundërpërgjigja në mënyrë që të arrihet efekti sa më i lartë te sjellja e tatimpaguesve në grupin e synuar, me përdorimin e sa më pak burimeve dhe të japë kështu orientime për Planin operativ, DTM dhe për zyrat regjionale, se si duhet t'i zhvillojnë veprimtaritë për përmbushjen e detyrimeve nga tatimpaguesit.

Treguesit kyç të performancës të përshkruar në këtë plan do të përdoren për të përcaktuar nëse ne jemi të suksesshëm në përmbushjen e objektivave tona dhe njëherit këta tregues do shërbejnë për vlerësimin e punës së stafit të angazhuar direkt në operacionet përmbushëse.

Ky Plan është aprovuar në mbledhjen e rregullt të menaxhmentit të lartë të ATK-së, 31.01.2018, dhe si i tillë konsiderohet version final dhe i gatshëm për implementim.

Përmbajtja

Përmbajtja:	3
1. Identifikimi i rreziqeve të Përbushjes.....	4
1.1 Regjistrim.....	4
1.2 Dokumentim.....	4
1.3 Deklarim	4
1.4 Pagesa.....	4
2. Rreziqet e përbushjes në TVSH	5
3. Rreziqet e përbushjes në TAK/TAP.....	8
4. Jodeklaruesit.....	10
5. Shpërndarja e kontrolleve dhe vizitave të bazuara në rrezik.....	12
6. Përshkrimi i trajtimit të rreziqeve për vitin 2018	13

1. Identifikimi i rreziqeve të Përmbushjes

1.1 Regjistrim: - Është kërkesa e parë e përmbushjes dhe si e tillë ka një rëndësi të jashtëzakonshme pasi që nga kjo fushë varet përfshirja e tatimpaguesve në sistemin e tatuarjes. Nga analizat e bëra rezulton se në kuadër të kësaj fushe mund të përmblihen këto rreziqe, si vijon:

- *Mos regjistrimi i Tatimpaguesve*
- *Mos regjistrimi në llogaritë përkatëse tatimore*
- *Mungesa e të dhënave specifike lidhur me Tatimpaguesin*
- *Të dhënat e pasakta në regjistrin e të dhënave*
- *Mos-përditësimi i të dhënave të Tatimpaguesit*



1.2 Dokumentim: - Në kuadër të kësaj fushe të përmbushjes e që ndërlidhet me mbajtjen e librave dhe regjistrimeve nga ana e tatimpaguesve sipas legjislacionit tatimor në fuqi, kemi identifikuar këto rreziqe kryesore, siç janë:

- *Mos-pajisja me Arka fiskale*
- *Mos-lëshimi i kuponëve fiskal*
- *Mos-mbajtja e regjistrimeve*
- *Regjistrime të pasakta*
- *Regjistrime fiktive*



1.3 Deklarim: - Një numër i konsiderueshëm i tatimpaguesve deklarojnë me vonesë, disa nga ta edhe nuk deklarojnë fare, numër po ashtu i konsiderueshëm i tyre nën-deklorojnë, këto të fundit ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e hendekut tatimor, të përmbledhura paraqesim rreziqet si vijon:

- *Mos-deklarim i të ardhurave*
- *Nën-deklarim*
- *Zbritje të palejueshme*
- *Kërkesa të pa baza për rimbursim*
- *Mos-dorëzim i deklaratës tatimore*
- *Dorëzim i deklaratës me vonesë*



1.4 Pagesa: - Në kuadër të kësaj fushe janë identifikuar këto rreziqe:

- *Mos-pagesë e detyrimeve tatimore*
- *Borxhet e vjetra*
- *Borxhet kritike*
- *Borxhet e reja*
- *Vonesë në pagesë*





2. Rreziqet e përmbushjes në TVSH

Rreziqet e përmbushjes në TVSH:



- *Mall pa origjinë & mungesë në stoqe;*
- *Kreditim i vazhdueshëm;*
- *Mos-aplikimi i ngarkesës së kundërt në sektorin e Ndërtimit;*
- *Mos-përputhje e deklarimit me informatat që ATK posedon;*
- *Nën-deklarim i çmimeve të shitjes.*



Mall pa origjinë & mungesë në stoqe: - Ekziston ende një numër i konsiderueshëm i tatimpaguesve të cilët kanë problemin e mallit pa origjinë si rezultat i blerjeve pa fatura, po ashtu shitje të pa deklaruar e cila reflekton pastaj si mungesë në stoqe. Rreziku i tillë është i shfaqur kryesisht në sektorët të cilët mbajnë vlera të mëdha të stoqeve siç janë: Tregtia, Industria përpunuese, Ndërtimtaria etj.

Në vijim do paraqesim rezultatet e vizitave në terren lidhur me mallin pa origjinë & mungesë në stoqe, për periudhat 2015-2017.




Kreditim i vazhdueshëm: - Nga 21,219 tatimpagues sa kanë deklaruar në TVSH gjatë vitit 2017, vetëm 40% e tyre kanë pasur detyrim pagese të paktën një herë gjatë gjithë vitit përkatës.






Mos-aplikimi i ngarkesës së kundërt në sektorin e Ndërtimit: - Kemi një numër të bizneseve në sektorin e Ndërtimitarisë të cilët nuk respektojnë bazën ligjore duke bërë kështu nën-deklarim. Nga numri total i deklaruesve të TVSH-së 1,350 t/p kanë plotësuar linjën 28 në deklaratën e TVSH-së.

Mos-përputhje e deklarimit me informatat që ATK posedon: - Poashtu ekziston edhe një numër i tatimpaguesve të cilët nuk kanë raportuar në deklarimet e tyre mujore për TVSH shumën e saktë të Importeve apo të Exporteve apo kanë mospërputhje mes qarkullimit nga Arka Fiskale dhe asaj të deklaruar në deklaratën e TVSH. Bazuar në raportet e blerjeve mbi 500 euro dhe të dhënave nga arkat numri i t/p që kanë mos-përputhje sipas viteve është si vijon:





Nën-deklarim i çmimeve të shitjes: ky trajtim synon të gjithë ato biznese të cilat nuk paraqesin saktë çmimin e shitjes së mallit, sipas vlerës së hapur të tregut. Nga 1,350 kontrolle të përfunduara 10% e tyre, përkatësisht 135 raste, kanë rezultuar me të gjetura rreth nën-deklarimit të çmimit të shitjes.

Nr. i rasteve me të gjetura mbi nën-deklarimin e çmimeve tek kontrollet e vitit 2017



3. Rreziqet e përmbushjes në TAK/TAP


Rreziqet e përmbushjes në TAK/TAP:

- Mos-mbajtje e regjistrimeve apo mbajtje jo e saktë e tyre;
- Mos-mbajtja në burim e tatimeve;
- Zbritje të palejueshme;
- Mos-regjistrim;
- Mos-dorëzim & vonesa në dorëzim deklarate.

Mos mbajtja në burim e tatimeve: Sipas analizave të bëra dhe raportit të Vlerësimit mbi shtrirjen e ekonomisë joformale në Kosovë, i publikuar në Nëntor të këtij viti, rreth 45 mijë punëtorë me orar të plotë janë të punësuar në ekonominë joformale dhe pjesa më e madhe në sektorin e Agrikulturës. Nga të dhënat që posedon ATK, numri i punëtorëve të deklaruar përgjatë viteve 2015-2017 ka pasur rritje mesatare prej 7.2%, derisa deklaratimet nga të vet-punësuarit dhe personat fizik kanë shënuar rënie të konsiderueshme. Vetëm gjatë periudhës Janar-Nëntor 2017 nga aktivitetet e realizuara në terren janë regjistruar rreth 1,363 punëtorë në sektorë të ndryshëm. Nëse krahasojmë me vite tjera 2015 dhe 2016, pjesa më e madhe e regjistrimeve nga vizitat është bërë në sektorin e Akomodimit dhe Shërbimit Ushqimor si dhe Tregti me Shumicë dhe Pakicë.

Mbi 1.6 milion euro qarkullim shtesë dhe mbi 260 mijë euro tatim shtesë kanë rezultuar nga vizitat në terren për periudhën Janar-Nëntor 2017, për mos mbajtje në burim të tatimit në qira. Nga mbi 16 mijë deklarues në WR për vitin 2017, 40% e atyre që kanë mbajtur në burim tatimin në qira i takojnë sektorit Tregti me shumicë dhe Pakicë, 10% Industrisë Përpunuese, 7% Aktiviteteve Profesionale dhe 4% Ndërtimtarisë, si sektorë të përmendur edhe në publikimet e fundit mbi ekonominë joformale.


Qarkullimi shtesë nga vizitat për mosmbajtje në burim të tatimit në qira



Mos mbajtja e regjistrimeve në rregull: Bazuar në raportet mbi trajtimin e rreziqeve deri më tani kemi 69% realizim të planit vjetor 2017 mbi pajisjen e bizneseve me arka fiskale. Nga aktivitetet në terren të realizuara gjatë këtij viti, numri më i madh i gjobave për mos-pajisje me arka fiskale është lëshuar në sektorin Tregti me shumicë dhe pakicë. Më poshtë në formë grafike janë paraqitur sektorët me më së shumti gjoba të lëshuara për mos-pajisje me arka fiskale, mos lëshim të kuponëve fiskal dhe mos-mbajtje të regjistrimeve në rregull.

Punëtorët e regjistruar nga aktivitetet në terren sipas sektorëve






Zbritje të pa lejueshme: Nga rezultatet kontrollet e realizuara gjatë periudhës Janar-Nëntor 2017, me qëllim të verifikimit të shpenzimeve se a janë të sakta apo ka fryrje të tyre, rezulton se Ndërtimtaria dhe Tregtia me shumicë dhe pakicë janë dy sektorët me mesataren më të lartë të tatimit shtesë për një kontroll.



Nën-deklarimet: Një dukuri tjetër jo e rrallë janë edhe deklarimet jo të sakta apo nën-deklarimet. Gjithnjë duke iu referuar rezultateve të dala nga terreni, sektorët Arsimi dhe Ndërtimtaria kanë mesataren më të lartë të tatimit shtesë për një kontroll.



Faktet nga kontrollet: Më poshtë janë listuar të gjitha faktet që kanë kontribuar në tatimin shtesë.



4. Jo-deklaruesit

Rreziqet tek jo-deklaruesit:

- Jo-deklarues në TVSH;
- Jo-deklarues për deklarimet tremujore dhe këstet paradhënie të tatimit në TAP dhe TAK;
- Jo-deklarues për WM/CM dhe WR
- Jo-deklarues për PD, CD dhe DO

Një nga dukurit që paraqet shqetësim të lartë për ATK janë edhe **jo-deklaruesit dhe ndalim-deklaruesit**. Derisa jo-deklaruesit janë ata tatimpagues të cilët asnjëherë nuk kanë dorëzuar deklarata tatimore, ndalim-deklaruesit janë ata tatimpagues që kanë deklaruar por kanë ndërprerë deklarimin.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ për trajtimin e jo-deklaruesve të datës 29.11.2017, llojet e jo deklaruesve dhe ndalim deklaruesve që janë identifikuar nga ATK-janë:

- Personat aktiv që zhvillojnë aktivitete ekonomike por që nuk deklarojnë,
- Personat të cilëve llogaritë tatimore nuk iu janë mbyllur me datën e lëshimit të vërtetimit tatimor për mbyllje,
- Personat që janë çregjistruar në ARBK por nuk janë mbyllur nga ATK,
- Personat jo aktiv, por që nuk kanë iniciuar asnjë procedurë për mbyllje të biznesit,
- Personat që kanë ndryshuar statusin e tyre dhe deklarojnë me numër fiskal të ri,
- Personat të cilët përkohësisht janë jo aktiv dhe nuk njoftojnë ATK për pasivizim të përkohshëm,
- Personat të cilat kanë llogari të hapur IS/QS ndërsa taten në të ardhura reale dhe anasjelltas,

- Personat të cilët kanë llogari tatimore aktive, ndërsa nuk janë të obliguar të deklarojnë përmes asaj llogarie,
- Personat fizik jo-afarist të cilët kanë llogari aktive ndërsa nuk janë të obliguar të deklarojnë përmes asaj llogarie.

Duke pasur parasysh faktin se ka rritje të vazhdueshme të deklaratave tatimore që mungojnë, ashtu siç edhe është definuar në udhëzim, ATK duhet të bëjë identifikimin e atyre tatimpaguesve që nuk deklarojnë apo ndalojnë të deklarojnë dhe krijimin e një procesi të vazhdueshëm për të përcjellë jo deklaruesit dhe ndalim deklaruesit.


Trajtimi i jo-deklaruesve sipas Udhëzimit Administrativ **për deklaratat mujore** do të përfshijë këto hapa:

1. Në rast të mosdeklarimit për herë të parë për periudhën përkatëse, tatimpaguesi njoftohet me mesazh apo përmes postës elektronike (e-mail), ku rikujtohet për deklarimin për periudhën përkatëse.
2. Në rast të mosdeklarimit për dy periudha të njëpasnjëshme, tatimpaguesi kontaktohet nga Qendra e Thirrjeve ku i kërkohet që të dorëzojë deklaratat për periudhat e padeklaruara.
3. Në rast të mosdeklarimit për tri periudha të njëpasnjëshme, Drejtoria Rajonale duhet të kontaktojë tatimpaguesin dhe të verifikojë gjendjen e tatimpaguesit, në mënyrë që të sigurojë deklaratat dhe t'i procesojë ato.
4. Në rast të mosdeklarimit për katër periudha të njëpasnjëshme, Drejtoria Rajonale bënë aprovimin për de-aktivizimin e llogarisë tatimore, tërheqjen e certifikatës së TVSH, si dhe ndërmerr të gjitha veprimet tjera, si informimi i Doganës, publikimi i listave dhe veprime tjera sipas procedurave me rastin e tërheqjes së certifikatës së TVSH-së.

Ndërsa, trajtimi i jo-deklaruesve sipas Udhëzimit Administrativ për **deklaratat tremujore dhe vjetore** do të përfshijë këto hapa:

1. Në rast të mosdeklarimit për periudhën përkatëse, tatimpaguesi njoftohet me mesazh apo përmes postës elektronike (e-mail), ku rikujtohet për deklarimin për periudhën përkatëse.
2. Pastaj, tatimpaguesi kontaktohet nga Qendra e Thirrjeve ku i kërkohet që të dorëzojë deklaratën për periudhën e padeklaruar.
3. Drejtoria Rajonale duhet të kontaktojë tatimpaguesin dhe të verifikojë gjendjen e tatimpaguesit, në mënyrë që të sigurojë deklaratat dhe t'i procesojë ato.
4. Në rast të mosdeklarimit atëherë Drejtoria Rajonale bënë aprovimin për de-aktivizimin e llogarisë tatimore, pasi të jenë përfunduar të gjitha procedurat nga Operativa, përfshirë edhe procedurat e Mbledhjes së Detyrueshme.

qarkullimit prinë sektori: tregtia me shumicë dhe pakicë, nga 832 vizita të realizuara me qarkullim shtesë mbi 2.5 milion euro; pastaj sektori i ndërtimtarisë, nga 200 vizita të realizuara me qarkullim shtesë mbi 1.1 milion euro; industria përpunuese, nga 216 vizita të realizuara me qarkullim shtesë 503,038 euro; aktivitetet profesionale-shkencore dhe teknike, nga 100 vizita të realizuara me qarkullim shtesë 479,671 euro, e kështu me radhë.



Bazuar nga të dhënat e raporteve në VKME, numri i vizitave për jo deklaruesit në periudhën Janar-Nëntor 2017 në sektor të ndryshëm, me rritje të

5. Shpërndarja e kontrolleve dhe vizitave të bazuara në rrezik

Kontrollet e detyrueshme 10%	Kontrollet e rastësishme 5%	Kontrollet e rimbursimit 10%	KONTROLLET & VIZITAT E BAZUARA NË RREZIK 75%							
Kontrollet e ç'rregjistrimit, etj.	Kontrollet e rastësishme	Kontrollet e rimbursimit	Mbulueshmëria sektoriale							
			Sektori i Ndërtimtarisë 20%	Sektori i Tregtisë me Shumicë dhe Pakicë 20%	Sektori i Industrisë Përpunuese 15%	Sektori i Aktiviteteve të Patundshmërive 5%	Sektori i Aktiviteteve financiare dhe të sigurimit 5%	Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor 10%	Aktivitetet e tjera Shërbyese 10%	Sektorët tjerë 15%
			Madhësitë e tatimpaguesve							
			Mikro 5%	Të vegjël 10%		Të mesëm 35%		Të mdhenjë & DTM 50%		
			Llojet e kontrolleve							
Kontrolle mujore 25%		Kontrolle Vjetore 45%			Kontrolle të gjata 30%					

6. Përshkrimi i trajtimit të rreziqeve për vitin 2018

<i>Fusha e përmbushjes</i>	<i>Rreziku i përmbushjes</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Masat për trajtim</i>	<i>Afatet kohore</i>	<i>Kriteri i suksesit</i>
Deklarim	Kreditim i vazhdueshëm	Trajtimi i bizneseve që operojnë me kreditim të vazhdueshëm, nga 21,219 tatimpagues sa kanë deklaruar në TVSH gjatë vitit 2017, vetëm 40% e tyre kanë pasur detyrim pagese të paktën një herë gjatë gjithë vitit përkatës.	<ul style="list-style-type: none"> • Informim & edukim • Vizita • Kontrolle • Moduli i Riskut 	Janar-Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> • 10% rritje e numrit të tatimpaguesve që bëjnë pagesa në TVSH gjatë një periudhe vjetore. Baza përlllogaritëse 2017.
Regjistrim	Mos regjistrimi	Tatimpaguesit të cilët sipas legjislacionit tatimor kërkohen të regjistrohen dhe të pajisen me numër fiskal dhe të cilët nuk e kanë bërë këtë gjë, apo tatimpaguesit të cilët janë të regjistruar dhe të pajisur me numër fiskal por nuk janë të regjistruar për TVSH apo ndonjë llogari tjetër përkatëse dhe janë të obliguar ta bëjnë.	<ul style="list-style-type: none"> • Informim & edukim • Vizita • Kontrolle • Qendra e thirrjeve • Moduli i Riskut 	Janar-Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e numrit të deklaruesve në TVSH për 15% pa ndryshuar pragu i regjistrimit; • Rritja për 100% e numrit të tatimpaguesve të regjistruar nga ATK përmes aktiviteteve operative. Baza përlllogaritëse 2017.
Deklarim	Mos-përputhje e deklarimit me informatat që ATK posedon	Tatimpaguesit të cilët në deklarimet e tyre raportojnë të dhëna të ndryshme me ato që ATK disponon. Ky rrezik përfshinë tatimpaguesit si vijon: - Mos-përputhje në mes të shumës së paraqitur në deklaratën e TVSH-së me të dhënat nga Dogana për importet / exportet e realizuara, - Mos-përputhje në mes qarkullimit të deklaruar në deklaratën e TVSh-së dhe qarkullimit në Arka Fiskale; - Mos-përputhje në mes të raportimit të blerjeve mbi 500 euro dhe atyre të deklaruara; - Mos-përputhje në mes të transaksioneve (librave të blerjeve/shitjeve) të raportuara dhe atyre të deklaruara.	<ul style="list-style-type: none"> • Informim & edukim • Vizita • Kontrolle • Moduli i Riskut 	Janar-Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> • Trajtimi i 90% të rasteve të identifikuara me raportime jo të sakta. Baza përlllogaritëse 2017.

Deklarim	Jo-deklaruesit dhe vonesat	Trajtimi i të gjithë bizneseve të regjistruara, si dhe personave fizik me të ardhura të vogla dhe të mëdha të cilët nuk deklarojnë, ndërprejnë deklarin apo paraqesin deklaratë me vonesë dhe ndërmarrja e hapave të nevojshëm nga ana e ATK-së me qëllim që tatimpaguesit e lartpërmendur të bëjnë deklarime e tyre brenda afateve të përcaktuara ligjore. Ky trajtim mbulon në veçanti sektorët si: tregti, shërbime, artistike, ndërtimtari, etj.	<ul style="list-style-type: none"> • Informim & edukim • Vizita • Kontrolle • Qendra e thirrjeve • Moduli i Riskut 	Afetet kohore do të bazohen në udhëzimin për trajtim të Jo-deklaruesve të datës 29.11.2017	<ul style="list-style-type: none"> • Trajtimi për 90% i të gjithë ndalim deklaruesve; • Zvogëlimi i numrit të jo-deklaruesve si vijon: - 70% në TVSH; - 90% në TAP dhe TAK. • Zvogëlimi i numrit të deklarimeve me vonesë për 40%. Baza përlllogaritëse 2017.
Dokumentim	Mall pa origjinë & mungesë në stoqe	Identifikimi dhe trajtimi i tatimpaguesve, si vijon: - Tatimpaguesit të cilët zotërojnë mallra dhe në bazë të legjislacionit në fuqi këto mallra nuk janë të dokumentuara mbi origjinë e tyre dhe bëjnë nën-deklarimin e tyre apo nuk janë në gjendje të ofrojë dokumentacionin mbështetës për mallin, i cili arsyeton prejardhjen e mallit si dhe vendndodhjen; - Tatimpaguesit të cilët nuk janë në gjendje të ofrojë dokumentacionin mbështetës, lidhur me mallrat në qarkullim (jashtë vendndodhjes/eve) së tatimpaguesit); - Tatimpaguesit të cilët duhet të jenë në gjendje të dokumentojnë të gjitha mallrat nga koha e pranimit derisa ato të jenë shitur apo të jenë sistemuar, përfshirë dokumentacionin e shitjes apo sistemimin. Trajtimi në fjalë do ti mbulojë kryesisht sektorët si: tregti, industria përpunuese, ndërtimtari, etj.	<ul style="list-style-type: none"> • Informim & edukim • Vizita • Kontrolle • Moduli i Riskut 	Janar-Prill Shtator-Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e vlerës së mallit pa origjinë për 40% duke u bazuar në aktivitetet operative të ATK-së në terren; • Rritja e vlerës së mungesës në stoqe për 30% duke u bazuar në aktivitetet operative të ATK-së në terren; Baza përlllogaritëse 2017.
Deklarim	Mos-aplikimi i ngarkesës së kundërt në Ndërtimtari	Trajtimi në fjalë përfshinë bizneset në sektorin e Ndërtimit të cilat nuk respektojnë bazën ligjore mbi aplikimin e Ngarkesës së Kundërt, duke bërë kështu nën-deklarim.	<ul style="list-style-type: none"> • Informim & edukim • Vizita • Kontrolle • Moduli i Riskut 	Janar-Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e numrit të bizneseve që aplikojnë ngarkesën e kundërt për 15%. Baza përlllogaritëse 2017.

Deklarim	Nën-deklarim i çmimeve të shitjes	Bizneset të cilat nuk deklarojnë saktë çmimin e shitjes së mallit, sipas vlerës së hapur të tregut <ul style="list-style-type: none"> • Shitje me pakicë dhe shumicë, • Aktivitetet shërbyese, • Aktivitetet e patundshmërisë • Aktivitetet e shëndetit të njeriut. 	<ul style="list-style-type: none"> • Informim & edukim • Vizita • Kontrolle • Moduli i Riskut 	Shkurt-Mars Korrik-Gusht Tetor-Nëntor	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja për 50% e rezultateve nga aktivitetet operative të ATK-së në terren. Baza përlogaritëse 2017.
Deklarim	Mos mbajtja në burim e tatimeve	Bazuar në vlerësimin e fundit mbi shtrirjen e ekonomisë jo-formale në Kosovë, të bërë nga BE, në Kosovë numri i të punësuarve në sektorin jo-formal arrin shifrën prej 45,000 punëtorë. Ndërsa një numër i bizneseve edhe pse deklarojnë për punëtorët pagesa e pagave bëhet me para të gatshme dhe ato nuk raportohen për të paguar tatimin e mbajtur në burim. E gjithë kjo ka ndikim të madh në të hyra dhe në kontributet për fondet e ndihmës sociale. Vlen të theksohet se deri më tani nga vizitat dhe kontrollet që janë realizuar gjatë periudhës Janar-Nëntor 2017, janë identifikuar vetëm 1,363 punëtor.	<ul style="list-style-type: none"> • Informim & edukim • Vizita • Kontrolle • Qendra e thirrjeve • Moduli i Riskut 	Janar-Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja për 100% e numrit të punëtorëve të regjistruar nga aktivitetet në terren. Baza përlogaritëse 2017.
Dokumentim	Mos mbajtja e regjistrimeve apo mbajtja e regjistrimeve të pa sakta	Bizneset të cilat përmes mos-mbajtjes në rregull të regjistrimeve iu shmangen detyrimeve tatimore, si: <ul style="list-style-type: none"> - Mos pajisja me arka fiskale; - Mos-lëshim i kuponëve fiskal gjatë shitjes; - Shfrytëzimi i pajisje jo fiskale, printerëve jo fiskal; - Mbajtja e regjistrimeve të dyfishta; - Mos informimi i ATK-së lidhur me ndryshimet si: NACE kodi, Adresa etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • Informim & edukim • Vizita • Kontrolle • Qendra e thirrjeve • Moduli i Riskut 	Janar-Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> • Trajtimi i 20% të rasteve që kanë pasur histori të mos-mbajtjes së regjistrimeve në rregull (gjoha mandatore); • Rritja për 20% e bizneseve të fiskalizuara. Baza përlogaritëse 2017.
Deklarim	Zbritjet e pa lejueshme	Identifikimi i bizneseve të cilat kanë koeficient të ulët të pagesave në raport me qarkullimin e deklaruar, andaj me qëllim të trajtimit të këtyre rasteve ATK duhet të ndërmarrë vizita dhe kontrole që të verifikojë shpenzimet e ndodhura se a janë të sakta apo ka zbritje të pa lejueshme.	<ul style="list-style-type: none"> • Informim & edukim • Vizita • Kontrolle • Moduli i Riskut 	Prill-Korrik	<ul style="list-style-type: none"> • Trajtimi i të gjitha rasteve me shkallë të lartë të rrezikshmërisë përpunuar nga analiza e rrezikut.

Deklarim	Nën-deklaruesit	Bizneset në kuadër të segmentit: bizneset e mesme dhe të mëdha, në veçanti në veprimtaritë: tregti, shërbime, ndërtimtari dhe prodhim të cilat nuk paraqesin deklarime të sakta - Bizneset e regjistruara në TAK të cilat deklarojnë me zero si dhe ata të cilët deklarojnë dhe paguajnë çdo tremujor nga 37.5€, si dhe bizneset të cilat qëndrojnë për një kohë të gjatë afër pragut për të hyrë në skemën e tatuarjes në të ardhura reale si dhe në TVSh veçanërisht bizneset në veprimtaritë si: tregti, shërbime profesionale, zbavitëse-artistike, etj.	<ul style="list-style-type: none"> • Informim & edukim • Vizita • Kontrolle • Moduli i Riskut 	Janar-Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> • Trajtimi i të gjitha rasteve me shkallë të lartë të rrezikshmërisë përpunuar nga analiza e rrezikut.
Pagesë	Mos pagesa e detyrimeve tatimore	Tatimpaguesit të cilët kanë detyrime të pa paguara ndaj ATK-së pavarësisht llojit tatimor	Ndërmarrja e të gjitha veprimeve sipas Legjislacionit Tatimor	Janar-Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> • Trajtimi i të gjitha rasteve
Pagesë	Vonesat në pagesat e detyrimeve tatimore	Tatimpaguesit të cilët kanë vonesa në kryerjen e detyrimeve tatimore, përkatësisht realizimin e pagesave me vonesa ndaj ATK-së pavarësisht llojit tatimor	Ndërmarrja e të gjitha veprimeve sipas Legjislacionit Tatimor nga ana e Mbledhjes së Detyrueshme	Janar-Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> • Trajtimi i të gjitha rasteve

ORGANIZIMI TERRITORIAL SIPAS ATK-së



www.atk-ks.org

Adresa: Këndi i rrugëve Bill Clinton & Dëshmorët e Kombit
10000 Prishtinë, KOSOVË

Tel & Fax: (+381 38) 200 250 48 & 200 250 07

E-mail: info@atk-ks.org